



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.32

2006

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.179, datë 22.2.2006	Për krijimin e njërive të integritit europian në ministrinë e linjës.....	1059
Vendim i KM nr.183, datë 2.3.2006	Për çmimin, formën, përmbajtjen, elementet e sigurisë dhe procedurat për pajisjen me Kartën e Studentit.....	1062
Vendim i KM nr.185, datë 29.3.2006	Për lejimin e ndërmarrjes "MEICO" të Ministrisë së Mbrojtjes, të përdorë procedurën "Prokurim i drejtpërdrejtë", për riparimin e helikopterëve BO 105 M VBH, të dhuruar nga Ministria e Mbrojtjes e Republikës federale të Gjermanisë, dhe për sigurimin e pajisjeve e të pjesëve të këmbimit për këta helikopterë.....	1063
Vendim i KM nr.186, datë 29.3.2006	Për një shtesë në vendimin nr.786, datë 17.12.1998 të Këshillit të Ministrave "Për kualifikimin shkencor, pasuniversitar dhe për klasifikimin e punonjësve, pedagogjikë e kërkimorë", të ndryshuar.....	1071
Vendim i KM nr.187, datë 29.3.2006	Për një shtesë në vendimin nr.523, datë 1.8.2003, të Këshillit të Ministrave "Për njohjen dhe ekuivalentimin e diplomave dhe certifikatave të fituara në shkollat e larta të huaja".....	1071
Vendim i ERE-s nr.22, datë 28.3.2006	Për përcaktimin e pagesave të rregullimit për vitin 2006 për operatorët e licencuar.....	1072
Vendim i ERE-s nr.23, datë 4.4.2006	Për fillimin e procedurave të shqyrtimit.....	1072

VENDIM
Nr. 179, datë 22.2.2006

PËR KRIJIMIN E NJËSIVE TË INTEGRIMIT EUROPIAN NË MINISTRITË E LINJËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të paragrafëve i parë dhe i dytë të nenit 4 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999, "Statusi i nëpunësit civil", me propozimin e Ministrit të Integrimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e njësive të integrimit europian, në përbërje të Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

2. Njësitë e integrimit europian të bashkërendojnë dhe të mbështesin punën e initecioneve respektive, për fushat e përqendruara në elementet kryesore të *acquis communautaire*, në zbatimin e marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, sipas përcaktimit të aneksit I, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Numri i nëpunësve të këtyre njësive të përcaktohet më varësi të çështjeve dhe nevojave të secilit institucion, të përmendur në pikën 1, të këtij vendimi.

4. Nëpunësit e njësive të integrimit europian emërohen sipas procedurave të përcaktuara në legjislacionin e shërbimit civil, në përputhje me kriteret e parashikuara në aneksin II, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Njësia e integrimit europian është përgjegjëse për:

a) bashkërendimin e brendshëm institucional, sigurimin e lidhjes së drejtëpërdrejtë dhe bashkërendimin e punës me Ministrinë e Integrimit dhe me ministrinë e tjera të linjës, për angazhimet e marra nga Republika e Shqipërisë, në kuadër të procesit të Stabilizim-Asociimit;

b) bashkërendimin e brendshëm institucional dhe bashkërendimin e punës me Ministrinë e Integrimit dhe me ministrinë e tjera të linjës, për procesin e përafrimit të legjislacionit vendas me *acquis communautaire* dhe për raportimin e akteve normative, që adaptojnë *acquis communautaire*, në kuadër të programit TAIEX;

c) bashkërendimin e brendshëm institucional për përgatitjen e raporteve për procesin e integrimit europian;

ç) monitorimin dhe raportimin brenda ministrisë për çështje të integrimit europian;

d) shpërndarjen e të dhënave për procesin e integrimit europian ndërmjet ministrisë ku bën pjesë, Ministrisë së Integrimit dhe njësive të integrimit europian në ministrinë e tjera të linjës;

dh) vlerësimin e veprimtarisë së institucionit në raport me ecurinë e procesit të integrimit europian, propozimin e mekanizmave funksionalë për lehtësimin e zbatimit të reformave sektoriale, nga zbatimi i marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, përmes procesit të përafrimit të legjislacionit vendas me *acquis communautaire*, dhe ngritjes së kapaciteteve administrative;

e) rekomandimin e përparësive, shpërndarjen e burimeve njerëzore dhe planifikimin e veprimtarive për mbështetjen institucionale të procesit të integrimit europian.

6. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxhetet vjetore, të parashikuara për këto ministri.

7. Ngarkohen ministrinë e përmendura në pikën 1, që, brenda muajit prill 2006, të paraqesin, për miratim, te Kryeministri, propozimet për implementimin e këtyre njësive në strukturat e tyre.

8. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Financave, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministria e Brendshme, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministria e Integritimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

ANEKSI I

FUSHAT SEKTORIALE QË DO TË KOORDINOHEN RESPEKTIVISHT NGA NJËSITË E INTEGRIMIT EUROPIAN

Institucioni	Fushat
	Sistemi gjyqësor: Reforma e gjyqësorit, pavarësia, transperenca, lufta kundër korrupsionit (trajnimin) - Të drejtat e njeriut - Lufta kundër korrupsionit
Ministria e Drejtësisë	- Bashkëpunimi gjyqësor në fushën civile dhe penale - Lufta kundër krimit të organizuar dhe trafikëve - Legjislacioni mbi shoqëritë tregtare - Trajtimi i të dhënave personale - Organizimi i tregjeve bujqësore - Shërbimet veterinareve dhe fitosanitare - Industria e agropërpunimit - Siguria ushqimore
Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit	- Politikat strukturore - Siguria e konsumatorit - Produktet bujqësore - Zhvillimi rural - Tregu i tokës (lëvizja e lirë e kapitaleve) - Lëvizja e lirë e mallrave dhe e shërbimeve
Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës	- Detyrimet në kuadër të OBT-së - Politikat mbi sipërmarrjet e mesme dhe të vogla - Ndihma shtetërore - Legjislacioni mbi shoqëritë tregtare - Politikat industriale - Bashkëpunimi doganor - Lufta ndaj kontrabandës - Bilanci i pagesave
Ministria e Financave	- Tatimi direkt dhe indirekt - Bashkëpunimi administrativ dhe lufta ndaj evazionit tatimor

	<ul style="list-style-type: none"> - Kontrolli financiar - Lufta ndaj mashtrimit - Buxheti dhe financat - Legjislacioni horizontal - Cilësia e ajrit - Menaxhimi i mbetjeve - Cilësia e ujit - Mbrojtja e natyrës - Kontrolli i mbrojtjes industriale
Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave	<ul style="list-style-type: none"> - Kimikatet dhe OMGJ-të - Zhurmat nga automjetet dhe makineritë - Siguria bërthamore dhe mbrojtja nga rrezatimi - Ndryshimet klimaterike - Mbrojtja civile - Bashkëpunimi ndërkombëtar - Politikat e peshkimit
Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta	<ul style="list-style-type: none"> - Lëvizja e lirë e punëtorëve/politika e migracionit - Legjislacioni i punës - Sigurimet shoqërore - Siguria dhe shëndeti në punë - Fondi Social Europian - Punësimi, mbrojtja sociale dhe dialogu social - Barazia gjinore/legjislacioni mbi antidiskriminimin - Menaxhimi i kufirit - Politikat e migracionit dhe azilit - Krimi i organizuar dhe korrupsioni - Bashkëpunimi policor
Ministria e Brendshme	<ul style="list-style-type: none"> - Trafiku i njerëzve dhe i narkotikëve - Pastrimi i parave - Terrorizmi - Performanca e administratës publike - Transporti tokësor, detar, hekurudhor, ajror dhe i kombinuar
Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit	<ul style="list-style-type: none"> - Teknologjia e informacionit - Telekomunikacioni
Ministria e Arsimit dhe Shkencës	<ul style="list-style-type: none"> - Arsimi, trajnimi dhe rinia - Shkenca dhe kërkimet - Njohja e ndërsjellë e kualifikimeve profesionale - Liria për të ofruar shërbime (pjesa e shërbimeve turistike hotele, agjencitë turistike etj.)
Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	<ul style="list-style-type: none"> -Arsimi, trajnimi dhe rinia -Pronësia intelektuale

ANEKSI II

KRITERET PËR PËRZGJEDHJEN E NËPUNËSVE TË NJËSIVE TË INTEGRIMIT EUROPIAN

Nëpunësi i Njesisë së Integrimit European duhet të përzgjidhet në bazë të kriterëve të përgjithshme të mëposhtme:

- Të ketë mbaruar arsimin e lartë (preferohet dega drejtësi ose ekonomi);
- Grada master në studime europiane dhe/ose ndërkombëtare përbën avantazh;
- Eksperienca në punë të ngjashme përbën avantazh;

- Të ketë aftësi në përgatitje raportesh, analizash, komunikim dhe prezantim;
- Të ketë njohuri shumë të mira në gjuhën angleze;
- Njohja e një gjuhe të dytë të BE-së përbën avantazh;
- Të përdorë programet bazë të punës në kompjuter;
- Të ketë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.

VENDIM

Nr. 183, datë 2.3.2006

PËR ÇMIMIN, FORMËN, PËRMBAJTJEN, ELEMENTET E SIGURISË DHE PROCEDURAT PËR PAJISJEN ME KARTËN E STUDENTIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 32, të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 2, të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005, “Për Buxhetin e Shtetit, të vitit 2006”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Kartës së Studentit, si dokument unik, që përdoret nga të gjithë studentët e arsimit të lartë, publik e jopublik, me kohë të plotë në Republikën e Shqipërisë.
2. Forma, përmbajtja dhe elementet e sigurisë së Kartës së Studentit të jenë sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Karta e Studentit lëshohet për një periudhë 1-vjeçare, kundrejt një çmimi prej 100 (njëqind) lekësh.
4. Procedura e pajisjes me Kartën e Studentit është si më poshtë vijon:
 - a) Studenti regjistrohet në sekretarinë e universitetit, në fillim të vitit akademik, plotëson dhe depoziton formularin tip, i cili përmban të dhëna individuale për çdo student, fotografinë dhe kërkesën për të pajisur me Kartën e Studentit, shoqëruar me pagesën e përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi;
 - b. Rektoratet e universiteteve, në fillim të vitit akademik, paraqesin në Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në formë elektronike, listat me emrat e studentëve të regjistruar, që do të pajisen me Kartën e Studentit, si dhe të gjitha të dhënat e përcaktuara në shkronjën ”a”, të kësaj pike;

c) Rektoratet e universiteteve derdhen në llogarinë e Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve shumë e mbledhur nga pagesa e tarifës për pajisjen me Kartën e Studentit, e cila kalon në zërin “Të ardhura dytësore”.

5. Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, për pajisjen e studentëve me kartë, krijon dhe administron bazën e të dhënave, për çdo student të pajisur me Kartën e Studentit, të cilën e përditëson çdo vit.

6. Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, e cila plotëson kartat e studentëve, sipas kërkesave të rektoratave, bashkëpunon me rektoratet e universiteteve, qeveritë studentore dhe organizatat e ndryshme rinore, për çdo problem, që ka të bëjë me pajisjen e studentëve me Kartën e Studentit, dhe shkëmben në mënyrë të ndërsjellë informacione për bazën e të dhënave.

7. Efekti financiar, prej 6 000 000 (gjashtë milionë) lekësh, për prodhimin e Kartës së Studentit, për vitin akademik 2006-2007, të përballohet nga buxheti i vitit 2006, i miratuar për Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

8. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për zbatimin e këtij vendimi dhe rektoratet e universiteteve për shpërndarjen e Kartës së Studentit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

ANEKSI I

FORMA, PËRMBAJTJA DHE ELEMENTET E SIGURISË TË KARTËS SË STUDENTIT

I. Forma e Kartës së Studentit do të ketë këto të dhëna:

Dokumenti i Kartës së Studentit është i formatit ID1 dhe përmasat e tij janë:

- gjatësi: 84 mm;
- gjerësi: 54 mm;
- trashësi 0.8 mm.

II. Përmbajtja dhe elementet e sigurisë kanë këto të dhëna:

1. Materiali do të jetë prej kartoni të plastifikuar ku janë të shtypura:

- Karta e Studentit
- Në krye të jetë: “stema e RSH dhe të shkruhet “Republika e Shqipërisë, Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve””.

- Emri, mbiemri i studentit;
- Datëlindja e studentit;
- Universiteti, dega, viti;
- Numri i serisë së Kartës së Studentit;
- Data e lëshimit të Kartës së Studentit;
- Periudha e vlefshmërisë.

2. Fotografia me ngjyra e mbajtësit të Kartës, jo më parë se tre muaj me përmasa 28 mm: 38 mm.

3. Vula e MTKRS, e cila përfshin një pjesë të fotos.

III. Pjesa e pasme e Kartës së Studentit do të ketë të dhënat dhe logon e prodhuesit të Kartës së Studentit, si dhe numrin e serisë të Kartës së Studentit.

VENDIM
Nr. 185, datë 29.3.2006

PËR LEJIMIN E NDËRMARRJES “MEICO” TË MINISTRISË SË MBROJTJES, TË PËRDORË PROCEDURËN “PROKURIM I DREJTPËRDREJTË”, PËR RIPARIMIN E HELIKOPTERËVE BO 105 M VBH, TË DHURUAR NGA MINISTRIA E MBROJTJES E REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË, DHE PËR SIGURIMIN E PAJISJEVE E TË PJESËVE TË KËMBIMIT PËR KËTA HELIKOPTERË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3, pika 3, shkronja “a”, 17, pika 5, dhe 19, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe të nenit 8, të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005, “Për Buxhetin e Shtetit, të vitit 2006”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e ndërmarrjes “MEICO”, të Ministrisë së Mbrojtjes, që për fondin limit prej 1 271 923 000 (një miliardë e dyqind e shtatëdhjetë e një milionë e nëntëqind e njëzet e tre mijë) lekësh, të parashikuar në buxhetet përkatëse të Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Shëndetësisë, për vitet 2006, 2007 dhe 2008, të përdorë procedurën “Prokurim i drejtpërdrejtë” me shoqërinë “Eurocopter Deutschland GmbH”, për riparimin e helikopterëve BO 105 M VBH, të dhuruar nga Ministria e Mbrojtjes e Republikës Federale të Gjermanisë, dhe për sigurimin e pajisjeve dhe pjesëve të këmbimit për këta helikopterë.

2. Ministria e Mbrojtjes dhe ndërmarrja “MEICO” të negociojnë të gjitha kushtet e kontratës me shoqërinë “Eurocopter Deutschland GmbH”, për riparimin e helikopterëve BO 105 M VBH, në përputhje me Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë dhe me praktikat ndërkombëtare të së drejtës private.

3. Helikopterët tip BO 105 M VBH, të riparuar dhe të përshtatur nga shoqëria “Eurocopter Deutschland GmbH” t’u shpërndahen:

- Ministrisë së Mbrojtjes 6 (gjashtë) helikopterë;
- Ministrisë së Brendshme 4 (katër) helikopterë;
- Ministrisë së Shëndetësisë 2 (dy) helikopterë.

4. Ministrinë përfituese, të përmendura në pikën 3, të këtij vendimi, të kryejnë pagesat paradhënie për vlerën e kontratës, doganën e TVSH-në për pajisjet dhe pjesët e këmbimit dhe komisionin në masën 1,5 për qind të vlerës së kontratës për ndërmarrjen “MEICO”, në llogarinë e kësaj ndërmarrjeje, në vlerën dhe sipas afateve të caktuara në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Ndërmarrja “MEICO”, nëpërmjet letërkreditit vjetor, të kryejë pagesat ndaj shoqërisë “Eurocopter Deutschland GmbH”, sipas detyrimeve të kontratës. Kryerja e pagesave ndaj kontraktorit të bëhet në euro, sipas kursit bankar të këmbimit në ditën e kryerjes së pagesës.

6. Ministrinë përfituese, brenda 15 ditëve nga miratimi i këtij vendimi, të lidhin marrëveshje për zbatimin e kontratës me ndërmarrjen “MEICO”.

7. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme dhe Ministria e Shëndetësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PAGESAT E INSTITUCIONEVE QË DO TË KRYHEN PËR NDËRMARJEN "MEICO"

Në milion lekë

Emërtimi	Viti 2006			Viti 2007			Viti 2008			Totali					
	Vlera totale	Nga të cilat		Vlera totale	Nga të cilat		Vlera totale	Nga të cilat		Vlera totale	Nga të cilat				
		Art.602	Art.231		Art.602	Art.231		Art.602	Art.231						
b	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15
				Afati pagesës				Afati pagesës							
Ministria e Mbrojtjes	369.677299	311.105	58.572	Brenda 10 ditëve nga nënshkrimi kontratës	288.842935	258.912	29.931	Brenda 30 ditëve nga çelja e buxhetit të vitit	144.3866095	119.852	24.534	Brenda 30 ditëve nga çelja e buxhetit të vitit	802.906843	689.870	113.037
Ministria e Brendshme	86.340755	78.691	7.650	Brenda 10 ditëve nga nënshkrimi kontratës	0	0.000	0.000	Brenda 30 ditëve nga çelja e buxhetit të vitit	256.89108	256.891	0.000	Brenda 30 ditëve nga çelja e buxhetit të vitit	343.231855	335.582	7.650
Ministria e Shëndetësisë	1.428	1.428	0.000	Brenda 10 ditëve nga nënshkrimi kontratës	179.4306725	171.781	7.650	Brenda 30 ditëve nga çelja e buxhetit të vitit	0	0.000	0.000	Brenda 30 ditëve nga çelja e buxhetit të vitit	180.8586725	173.209	7.650
TOTALI	457.446054	391.22405	66.222		468.273608	430.69298	37.58063		401.27769	376.74353	24.53416		1326.99735	1198.6606	128.3368

TABELA 1. MINISTERIA E MBROJTJES
(Detyrimet sipas viteve për 6 helikopterët BO 105, konfiguracion A-1; B-1,2 dhe C - 1,2,3)

ZËRAT	2006 (€)	2007 (€)	2008 (€)	TOTALI (€)
<i>Riparim i helikopterëve</i>				
- Varianti mjekësor (1 A1)	1 x 678.183 = 678.183			1 A1
- Varianti M. rolesh (1 B1, 1 B2)	2 x 681.338 = 1.362.676			1B1 + 1 B2
- Varianti SAR (1 C1 + 1 C2 + 1 C3)		2 x 979.849 = 1.959.698	1 x 936.875 = 936.875	1C1 + 1 C2 + 1C3
SHUMA	1A + 2B = 2.040.859	2C = 1.959.698	1C = 936.875	= 4.937.432
<i>Trajnim personeli</i>				
- Pilote	4 x 16.220 = 64.880	4 x 16.787 = 67.151		
- Instr.pilot	1 x 14.160 = 14.160			
- Specialiste	4 x 11.200 = 44.800			
SHUMA	= 123.840	= 67.151		= 190.991
<i>Pajisje/Pjesë këmbimi</i>				
- Paketa e1 ⁰	602.432	195.625		
- Paketa e2 ⁰			160.354	
- Paketa e3 ⁰				
SHUMA	= 602.432	= 195.625	= 160.354	= 958.411
TOTALI	2.767.131	2.222.474	1.097.229	6.086.934

TABELA 2. MINISTERIA E BRENDSHME
(Detyrimet sipas viteve për 4 helikopterët BO 105, konfiguracion B-1; D-1,2 dhe C -- 4)

ZËRAT	2006	2007	2008	TOTALI
<i>Riparim i helikopterëve</i>				
- Varianti VIP (1 D1 + D2)	1 x 590.842 = 590.842	-	1 x 632.925 = 632.925	1 D1 + 1 D2
- Varianti Shumërolesh (1 B3)	_____	-	1 x 715.098 = 715.098	1 B3
- Varianti SAR (1 C4)	_____	-	1 x 666.809 = 666.809	1 C4
SHUMA	= 590.842		= 2.014.832	= 2.605.674
<i>Trajnim personeli</i>				
- Instr.pilot	1 x 14.160 = 14.160	-	-	
- Specialiste	1 x 11.200 = 11.200	-	-	
SHUMA	= 25.360			= 25.360
<i>Pajisje/Pjesë këmbimi</i>				
- Paketa e 1 ^o	50.000	-	-	
- Paketa e 2 ^o	_____	-	-	
- Paketa e 3 ^o	_____	-	-	
SHUMA	= 50.000			= 50.000
TOTALI	666.202	-	2.014.832	2.681.034

TABELA 3. MINISTRIA E SHËNDETËSISË
(Detyrimet sipas viteve për 2 helikopterët BO 105, konfiguracio A – A 2, 3)

ZËRAT	2006	2007	2008	TOTALI
<i>Riparim i helikoptere</i>				
- Varianti mjekësor (1 A2 + 1 A3)	_____	1 x 682.258 = 682.258 1 x 632.618 = 632.618		1 A2 1 A3
SHUMA		= 1.314.876		= 1.314.876
<i>Trajnim personeli</i>				
- Pilote	_____	1 x 16.787 = 16.787	-	
- Instr.pilot	_____	1 x 14.656 = 14.656	-	
- Specialiste	_____	_____		
	1 x 11.200 = 11.200			
SHUMA	= 11.200	= 31.443		= 42.643
<i>Pajisje /Pjesë këmbimi</i>				
- Paketa e 1 ⁰	_____	-	-	
- Paketa e 2 ⁰	_____	50.000	-	
- Paketa e 3 ⁰	_____	-	-	
SHUMA		= 50.000		= 50.000
TOTALI	11.200	1.396.319	-	1.407.519

TABELA 4. PËRMBLEDHJE E DETYRIMEVE KONTRAKTORE TË MINISTRIVE SIPAS VITEVE
(për helikopterët BO -105 sipas konfiguracioneve A – 1,2,3; B – 1,2,3; C 1,2,3,4 dhe D – 1,2)

Nr.	Institucioni	2006 (€)	2007 (€)	2008 (€)	Vlera totale (€)
1	Ministria e Mbrojtjes (6 copë) (A-1; B-1,2 C – 1,2,3)	2. 767.131	2.222.474	1.097.229	6.086.834
2	Ministria e Brendshme (4 copë) (B – 1; C -4; D- 1,2)	666.202	-	2.014.832	2.681.034
3	Ministria e Shëndetësisë A – 2, 3	11.200	1.396.319	-	1.407.519
4	SHUMA	3.444.533	3.618.793	3.112.061	10.175.387

VENDIM
Nr. 186, datë 29.3.2006

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.786, DATË 17.12.1998 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KUALIFIKIMIN SHKENCOR, PASUNIVERSITAR DHE PËR
KLASIFIKIMIN E PUNONJËSVE, PEDAGOGJIKË E KËRKIMORË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 43, të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në fund të pikës 7.2, të vendimit nr.786, datë 17.12.1998, të Këshillit të Ministrave, të shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Në rastet kur diploma master është vazhdim i pandërprerë nga cikli i parë, i studimeve Bachelor, kjo diplomë do të njihet sipas vendimit nr.523, datë 1.8.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për njohjen dhe ekuivalentimin e diplomave dhe të certifikatave, të fituara në shkollat e larta të huaja”, të ndryshuar.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 187, datë 29.3.2006

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.523, DATË 1.8.2003, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR NJOHJEN DHE EKUIVALENTIMIN E DIPLOMAVE DHE
CERTIFIKATAVE TË FITUARA NË SHKOLLAT E LARTA TË HUAJA”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 43, të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas paragrafit të parë të pikës 3, të vendimit nr.523, datë 1.8.2003, të Këshillit të Ministrave, të shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Nga ky rregull përjashtohen rastet kur ka marrëveshje ndërqeveritare apo dypalëshe, në fushën e arsimit dhe shkencës dhe rastet kur paraqiten nga i njëjti shtet, tituj diplomash të njohura më parë nga komisionet. Njohja në këto raste të jetë e drejtpërdrejtë.”.

2. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 22, datë 28.3.2006

**PËR PËRCAKTIMIN E PAGESAVE TË RREGULLIMIT PËR VITIN 2006 PËR
OPERATORËT E LICENCUAR**

Në zbatim të neneve 9 dhe 12 pika 1, 3, 4, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003, "Për sektorin e energjisë elektrike", Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike, në mbledhjen e tij të datës 28.3.2006, mbasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Departamenti i Administrimit, Financës, Burimeve Njerëzore dhe Protokoll Arshivës, Departamenti i Tarifave dhe i Çmimeve, si dhe Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit, për përcaktimin e pagesave të rregullimit për vitin 2006 për operatorët e licencuar:

VENDOSI:

1. Pagesat e rregullimit për operatorët e licencuar për vitin 2006 të jenë sipas tabelës që i bashkëngjitet këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti i Administrimit, Financës, Burimeve Njerëzore dhe Protokoll Arshivës të njoftojë të licencuarit për shumën e detyrimit sipas pikës 1 të këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema

Nr.	Kompania	Pagesa Rregullimit sipas të ardhurave për vitin 2006 (lekë)
1	ESSEGEI SHQIPËRI SMOKTHINA sh.p.k	128.000
2	HYDROELECTRIC COMPANY OF ALBANIA sh.p.k	68.000
3	EMIKEL 2003 sh.p.k	22.000
4	AMAL sh.p.k	7.000
5	SPAHIU-GJANC sh.p.k	41.000
6	WONDER-POWER sh.a	47.000
7	SARMIER sh.p.k	6.000
8	SAROLLI sh.p.k	1.000
9	JUANA sh.p.k	1.000
10	WTS ENERGJI sh.p.k	1.000
11	MARJAKAJ sh.p.k	1.000
12	DARDANIA ENERGJI sh.p.k	1.000
13	MAKSI ELEKTRIK sh.p.k	1.000
14	FAVINA 1 sh.p.k	7.000
15	GSA sh.p.k	17.000
16	DARFO sh.p.k	11.000
17	OST sh.a	3.184.000
18	KESH sh.a	38.623.000
	Shuma për ERE	42.167.000

VENDIM
Nr. 23, datë 4.4.2006

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT

Në mbështetje të nenit 9, dhe nenit 13, pika 1, germa dh, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr.26, datë 13.5.2004, “Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, ndryshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.25, datë 27.5.2005, neni 11, germa A, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 4.4.2006, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria “Wonder Power” sh.a., për licencimin për aktivitetin e importit të energjisë elektrike,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit, për licencimin e shoqërisë “Wonder Power” sh.a. për aktivitetin e importit të energjisë elektrike.
2. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit, si dhe Departamenti i Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënieve me Publikun, për shqyrtimin e kërkesës së paraqitur nga shoqëria “Wonder Power” sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi Zhan d'Ark, prapa ish-Ekspozitës "Shqipëria Sot", Tel: 042 555 63; ose 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2006 është 18 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
 - 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
 - 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
 - 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI**
-
- 1. PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006) 1500**
 - 2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005) 600**
 - 3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vëllimi i II-të-2006).... 1500**
 - 4. PËR TAKSAT DHE TATIMET (+suplement 2006) 1500**
-
- 1. TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT..... 1500**
 - 2. TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT..... 2000**

BOTIME TË REJA

- 1. PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT 500**
- 2. KODI DOGANOR 1000**
- 3. KODI DETAR 1000**

U dorëzua për shtyp më 12.4.2006
Doli nga shtypi më 19.4.2006

Tirazhi: 4000 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2006

Çmimi: 150 lekë